



Group of States against Corruption
Groupe d'États contre la corruption

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Miratuar më: 24 shtator 2020

Publikuar më: 6 tetor 2020

Publik

Greco RC4(2020)5

RAUNDI I KATËRT I VLERËSIMIT

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët,
gjyqtarët dhe prokurorët

SHTOJCË E

RAPORTIT TË DYTË TË
PËRPUTHSHMËRISË

SHQIPËRI

Miratuar nga GRECO në Mbledhjen Plenare të 85^{të}
(Strasburg, 21-25 shtator 2020)

R
A
U
N
D
I

I

K
A
T
Ë
R
T
I

V
L
E
R
R

I. HYRJE

1. Shtojca e Raportit të Dytë të Përputhshmërisë vlerëson masat e marra nga autoritetet e Shqipërisë për të zbatuar rekomandimet e nxjerra në Raportin e Raundit të Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë (shih paragrafin 2) që kanë të bëjnë me "Parandalimin e korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët".
2. Raporti i Raundit të Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë u miratua në Mbledhjen Plenare të 63^{të} të GRECO-s (datë 28 mars 2014) dhe është bërë publik më datë 27 qershor 2014, në vijim të autorizimit të Shqipërisë ([Greco Eval IV Rep \(2013\) 9E](#)).
3. Raporti i Përputhshmërisë i Raundit të Katërt u miratua në Mbledhjen Plenare të 71^{të} të GRECO-s (datë 18 mars 2016) dhe është bërë publik më datë 15 prill 2016, në vijim të autorizimit të Shqipërisë ([GrecoRC4\(2016\)6](#)).
4. Raporti i Dytë i Përputhshmërisë ([GrecoRC4\(2018\)4](#)) u miratua në Mbledhjen Plenare të 80^{të} të GRECO-s (18-22 qershor 2018) dhe është bërë publik më datë 12 korrik 2018, në vijim të autorizimit të Shqipërisë.
5. Siç kërkohet nga Rregullat e Procedurës së GRECO-s, autoritetet e Shqipërisë paraqitën një Raport mbi situatën aktuale me informacion shtesë në lidhje me masat e marra për të zbatuar gjashtë rekomandimet e mbetura të zbatuara pjesërisht, sipas Raportit të Përputhshmërisë. Ky raport është marrë më datë 30 mars 2019 dhe u përditësua më datë 2 tetor 2019 dhe ka shërbyer si bazë për këtë Shtojcë të Raportit të Dytë të Përputhshmërisë.
6. GRECO përzgjodhi Qipron dhe Maqedoninë e Veriut për të caktuar Relatorët për procedurën e përputhshmërisë. Relatorët e caktuar për këtë raport ishin, në emër të Qipros, Znj. Alexia KALISPERA, dhe në emër të të Maqedonisë së Veriut, Znj. Ana PAVLOVSKA-DANEVA. Në hartimin e kësaj Shtojce të Raportit të Dytë të Përputhshmërisë ato u ndihmuan nga Sekretariati i GRECO-s.

II. ANALIZA

7. Kujtojmë që GRECO i trajtoi dhjetë rekomandimet për Shqipërinë në Raportin e tij të Vlerësimit. Në Raportin e dytë të Përputhshmërisë, GRECO nxorri përfundimin që rekomandimet i, iv, v dhe x janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe rekomandimet ii, iii, vi, vii, viii dhe ix janë zbatuar pjesërisht nga Shqipëria. Përputhshmëria e rekomandimeve të mbetura do të trajtohet më poshtë.

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët

Rekomandimi ii.

8. *GRECO rekomandoi që i) Kodi i Sjelljes për deputetët, i parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, të përpunohet dhe të zbatohet siç duhet; dhe ii) trajnimi, udhëzimi dhe këshillimi të vihen në dispozicion të deputetëve për çështje të tilla si forma, mënyra dhe objekti i kontakteve të lejueshme me grupet e interesit dhe lobistët, deklarimi i konflikteve ad hoc të interesit, etikës dhe parandalimit të korrupsionit brenda radhëve të tyre.*
9. Kujtojmë që në Raportin e dytë të Përputhshmërisë, GRECO doli në përfundimin që ky rekomandim ishte zbatuar në mënyrë të pjesshme. GRECO mirëpriti miratimin e Kodit të Sjelljes për deputetët që mbulon çështje që kanë të bëjnë me integritetin dhe ishte në pritje të marrjes së Udhëzimeve për zbatimin e Kodit. Ai vuri në dukje paqartësitë e mbetura në lidhje me procedurën për të siguruar zbatimin e duhur të rregullave të Kodit dhe sanksioneve të zbatueshme për deputetët në rastet e shkeljes

së këtij Kodi. Për të lehtësuar zbatimin e Kodit u rekomanduan nxjerrja e udhëzimeve të duhura dhe trajnimi dhe këshillimi i përshtatshëm.

10. Autoritetet shqiptare sqarojnë se Udhëzimet e detajuara për zbatimin e Kodit të Sjelljes për deputetët janë miratuar më datë 27 shtator 2018 dhe janë publikuar në faqen e internetit të Kuvendit. Kodi i Sjelljes dhe Udhëzimet u janë dërguar deputetëve me anë të postës elektronike dhe në formë të shtypur në muajin tetor 2018. Ato u janë shpërndanë gjithashtu të gjitha grupeve parlamentare, në formën e një broshure, në muajin janar 2019.
11. Për më shumë, më datë 18 korrik 2019 u ndryshua Rregullorja e Kuvendit për të përcaktuar qartë detyrimin për të respektuar Rregulloren dhe Kodin, si dhe për përcaktimin e masave disiplinore dhe procedurën përkatëse në rast të shkeljeve të këtyre instrumenteve. Kreu IX mbi "Rregullat dhe sjellja në Kuvend" është riformuluar për të bërë të qartë se rregullat dhe masat disiplinore të përcaktuara në këtë kre zbatohen për shkeljen e Rregullores dhe Kodit të Sjelljes. "Sekretariati për procedurat, votimet dhe etikën", i riorganizuar, është bërë shkalla e parë që vendos masa të rrepta disiplinore, Byroja e Kuvendit është kompetente për shkallën e dytë.
12. Autoritetet shqiptare sqarojnë gjithashtu se në muajin nëntor 2018 u organizuan tre seanca informative për Kodin e Sjelljes dhe Udhëzimet për 37 deputetë në lidhje me "Parandalimin e konfliktit të interesave, mekanizmat parandalues, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave". Në muajin mars 2019, Parlamenti organizoi një takim këshillues dhe orientues me pjesëmarrjen e deputetëve të sapoemëruar, deputetëve me përvojë të gjatë, Sekretarit të Përgjithshëm të Parlamentit dhe drejtorëve të administratës së Kuvendit për të informuar, orientuar dhe këshilluar ata në veçanti për të drejtat dhe detyrimet e deputetëve sipas Kodit të Sjelljes dhe Udhëzimet. Më datë 6 nëntor 2018, Kuvendi dhe Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) organizuan një simpozium për konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurive me pjesëmarrjen e 33 deputetëve, nëpunësve civilë të Kuvendit dhe përfaqësues të ILDKPKI, Delegacionit të BE-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
13. Përsa i përket sistemit për këshillimin e deputetëve për çështje etike, autoritetet shqiptare tregojnë se në Kuvend, në përputhje me Ligjin mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, është ngritur Autoriteti Përgjegjës Ligjor, që përfshin dy persona nga Shërbimi i Burimeve Njerëzore i Kuvendit dhe Drejtoria e Përfitimeve të Parlamentarëve, për të ofruar këshillim për deputetët. Gjatë procesit të deklarimit të pasurive dhe interesave private (gjatë tremujorit të parë të çdo viti), Autoriteti Përgjegjës siguron mesatarisht 30-40 këshilla për deputetët se si të plotësojnë dokumentet përkatëse. Gjatë muajve tetor 2019 dhe shkurt 2020, ky autoritet ka këshilluar gjithashtu dy deputetë, me kërkesën e tyre (personalisht ose përmes telefonatave), për çështje të aktiviteteve të jashtme. Autoritetet shqiptare shtojnë se gjatë seancave plenare ose mbledhjeve të komisioneve, Kryetari ose kryetarët e komisioneve dhe grupeve parlamentare shpesh këshillojnë deputetët për zbatimin e Kodit të Sjelljes.
14. Për më tepër, që nga tetori 2018 janë publikuar thirrje të njëpasnjëshme publike për akreditimin e lobistëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile, bazuar në nenin 22 të Kodit të Sjelljes dhe nenin 18 të Udhëzimeve. Deri më datë 15 shkurt 2019 kanë shprehur interes 27 grupe interesi dhe organizata të shoqërisë civile. "Regjistri i lobistëve, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile" është bërë publik në faqen e internetit të Kuvendit. Ai përmban një listë të subjekteve të akredituara nga Kuvendi, të ndara sipas fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare, si dhe detajet e administratorëve të tyre.

15. Gjithashtu, është hartuar një regjistër i veçantë elektronik për dhuratat dhe është publikuar në faqen e internetit të Kuvendit. Në Kuvend është krijuar një ambient i veçantë për ekspozimin dhe ruajtjen e dhuratave të marra nga deputetët dhe është krijuar një komision për përcaktimin e vlerës së dhuratave.
16. GRECO mirëpret masat e marra që prej miratimit të Kodit të Sjelljes për deputetët me qëllim që të rritet zbatimi i tij dhe rritja e ndërgjegjësimit mes deputetëve për Kodin. Udhëzimet më të fundit për zbatimin e Kodit të Sjelljes plotësojnë në mënyrë të dobishme rregullat e përfshira në Kod, dhe në këtë drejtim, janë marrë masa të duhura në lidhje me ndërgjegjësimin dhe trajnimet. GRECO mirëpret gjithashtu ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të cilat qartësojnë dhe përforcojnë mekanizmat e zbatimit dhe sanksionit në rast të shkeljeve të Kodit. GRECO mirëpret gjithashtu sistemin e vendosur për ofrimin e këshillimit për deputetët për çështje etike, si në mënyrë informale, përmes Kryetarit dhe kryetarëve të komisioneve dhe grupeve parlamentare, dhe në mënyrë më të zyrtarizuar përmes organizimit të një takimi këshillimor dhe orientues me pjesëmarrjen e deputetëve të sapoemëruar, si dhe rolin zyrtar që i është caktuar Autoritetit Përgjegjës Ligjor për të ofruar këshillim sipas kërkesës.
17. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi ii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Recommendation iii.

18. *GRECO rekomandoi që të krijohet një mekanizëm në Kuvend për njoftimin nga deputetët të konflikteve të interesit "rast pas rasti" dhe që funksionimi i këtij mekanizmi t'i nënshtrohet monitorimit.*
19. Kujtojmë që në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë, GRECO arriti në përfundimin se ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. GRECO mirëpriti faktin që Kodi i ri i Sjelljes për deputetët parashikoi një procedurë të qartë për njoftimin ad hoc të konflikteve të interesit. Ai tregoi që sukcesi i kësaj procedure do të varet nga zbatimi efektiv i Kodit, përfshirë zbatimin e sanksioneve në rast shkeljesh, të cilat mungonin në Kod. Ai gjithashtu rekomandoi që brenda Kuvendit të zhvillohen trajnimet e duhura për konfliktet e interesit.
20. Autoritetet e Shqipërisë bëjnë të ditur tani që gjatë mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave plenare deputetët informohen nga Autoriteti Përgjegjës Ligjor i Kuvendit për detyrimet e tyre për të deklaruar konfliktet e interesit rast pas rasti. Pas paraqitjes së njoftimeve rast pas rasti të konfliktit të interesit, Kryetari, në seancën plenare, informon Kuvendin për këto njoftime. Një regjistër i deklaratave të konfliktit të interesit publikohet në faqen e internetit të Kuvendit dhe mbahet i përditësuar. Që nga Raporti i Dytë i Përputhshmërisë, pesë deputetë kanë njoftuar interesa private rast pas rasti, sipas kësaj procedure.
21. Autoriteti Përgjegjës Ligjor monitoron këtë mekanizëm deklarimi dhe vepron në përputhje me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe urdhrat e nxjerra nga ILDKPKI, të cilit Autoriteti i raporton çdo vit të gjitha deklaratat. Rregullorja e Kuvendit parashikon që shkeljet e rregullave të konfliktit të interesit sanksionohen në përputhje me legjislacionin përkatës (Kreu IX, Neni 62/1).
22. Veç kësaj, autoritetet shqiptare i referohen edhe ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit në lidhje me procedurën disiplinore dhe sanksionet (shih rekomandimin ii më lart).

23. GRECO mirëpret që masat e hartuara nga Kuvendi për të siguruar zbatimin e duhur të Kodit të Sjelljes kanë rezultuar në një sistem njoftimesh të konfliktit të interesit rast pas rasti. Ai vëren se deklaratat bëhen publike si brenda Kuvendit ashtu edhe për publikun përmes faqes në internet. GRECO inkurajon autoritetet shqiptare të sigurojnë një përditësim të vazhdueshëm të këtij informacioni. Ai gjithashtu mirëpret ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të cilat sqarojnë dhe përforcojnë mekanizmat e zbatimit dhe sanksionimit në rast të shkeljes së detyrimeve dhe procedurës së përcaktuar në lidhje me deklarimin rast pas rasti të konfliktit të interesit. Ai vë në dukje se funksionimi i duhur i këtij sistemi të deklarimit rast pas rasti sigurohet nga një mekanizëm monitorimi i ushtruar nga Autoriteti Përgjegjës Ligjor nën mbikëqyrjen e ILDKPKI.
24. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi iii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Parandalimi i korrupsionit përsa i përket gjyqtarëve dhe prokurorëve

25. Siç u përmend në raportet e mëparshme, në vitin 2014 në Shqipëri filloi një reformë e gjerë në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë ndryshimet kushtetuese¹ dhe një sërë ligjesh organike që synojnë përforcimin e garancive të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit dhe integritetit brenda sistemit gjyqësor dhe përmirësimin e funksionimit të tij. Brenda kuadrit të kësaj reforme, janë krijuar një numër institucionesh të reja, duke përfshirë ndër të tjera Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) që zëvendëson ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Për më shumë, filloi gjithashtu një vlerësim i gjerë i gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim, ndër të tjera, luftimin e korrupsionit në sistemin gjyqësor². Ky proces rivlerësimi (vetingu) është ende duke u kryer dhe përfshin një numër të madh gjyqtarësh dhe prokurorësh shqiptarë.
26. Autoritetet shqiptare shprehen se Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka intensifikuar përpjekjet për të trajtuar përparësitë dhe mangësitë më urgjente të sistemit gjyqësor. Deri më datë 17 shkurt 2019, KLGJ ka miratuar 395 vendime në lidhje me:
- Planin Strategjik 2019 - 2020 për të rritur përdorimin efektiv të burimeve, përforcimin e funksionimit, dhe sigurimin e koordinimit me palët e tjera të interesit;
 - pavarësinë, llogaridhënien dhe efektivitetin e pushteti gjyqësor (zgjedhja e nënkryetarëve të gjykatave, funksionimi i këshillave gjyqësorë, delegimi gjyqësor, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve);
 - monitorimin e performancës së gjykatave;
 - organizimin e programit të trajnimit fillestar gjyqësor në Shkollën e Magjistraturës;
 - kriteret ligjore për ushtrimin e detyrës së kancelarëve;
 - dosjet personale dhe regjistrat e magjistratëve;
 - hartën gjyqësore;
 - vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve;
 - rregullat dhe kriteret për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve;
 - krijimin e gjykatave të veçanta për gjykimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar.
27. KLGJ ka qenë pjesë e procesit të ri-vlerësimit duke mbështetur Komisionin e Pavarur të Kualifikimit përmes përgatitjes së relacioneve për analizën e aftësive profesionale

¹ Komisioni i Venecias, "[Opinion paraprak për projekt ndryshimet kushtetuese për pushtetin gjyqësor në Shqipëri](#)", miratuar në seancën plenare të 105^{te} (Venecia, 18-19 dhjetor 2015), CDL-AD(2015)045; "[Opinion përfundimtar mbi projektin e rishikuar të ndryshimeve kushtetuese për pushtetin gjyqësor në Shqipëri](#)", miratuar në seancën plenare të 106^{te} (Venecia, 11-12 mars 2016), CDL-AD(2016)009, për shembull, paragrafët 7-8, 52-57, 74 dhe 86-87 .

² Komisioni i Venecias, "[Shqipëri - Letër Amicus Curiae për Gjykatën kushtetuese mbi ligjin për Ri-vlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve \(Liqji i Vetingut\)](#)", miratuar në Seancën Plenare të 109^{te} (Venecia, 9-10 dhjetor 2016), CDL-AD(2016)036-e, për shembull paragrafët 59 deri 64.

të subjekteve të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ai ka ngritur "Komisionin *ad-hoc* për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Kuadër të Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve".

Rekomandimi vi.

28. *GRECO ka rekomanduar që i) përzgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të jetë transparent dhe në këto procese të kërkohet opinioni i gjyqësorit (p.sh. i vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë); dhe ii) vlerësimi periodik i performancës profesionale dhe etike të gjyqtarëve të realizohet në kohë dhe t'i jepet rëndësi garantimit që kriteret për vlerësimin e sjelljes etike të gjyqtarëve të jenë objektive dhe transparente, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit.*
29. Kujtojmë që në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë, GRECO arriti në përfundimin se ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. Më konkretisht, GRECO e konsideroi pjesën e parë të rekomandimit të zbatuar në mënyrë të kënaqshme: ai mirëpriti ndryshimet kushtetuese të cilat kufizuan rolin e Presidentit të Republikës në emërimin zyrtar të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pas propozimit nga KLGJ-ja e sapo krijuar. GRECO gjithashtu konstatoi se përbërja e KLGJ-së, duke përfshirë shumicën e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegët e tyre, përmbush në përgjithësi objektivat e pjesës së parë të rekomandimit. Në lidhje me pjesën e dytë të rekomandimit, GRECO vuri në dukje se kriteret për vlerësimin e magjistratëve ishin përcaktuar në Ligjin Nr. 96/2016, por mbeten të shqetësuar nga hendeku kohor, që mund të jetë më shumë se gjashtë vjet, midis viteve të referencës për vlerësimin e gjyqtarëve dhe ciklet përkatëse të vlerësimeve. GRECO konsideroi se ky hendek kohor mbetet një vështirësi dhe se vlerësimet periodike të gjyqtarëve nuk u kryen në kohën e duhur. Prandaj kjo pjesë e rekomandimit ishte zbatuar pjesërisht.
30. Për sa i përket përzgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, autoritetet shqiptare bëjnë tani të ditur që KLGJ ka miratuar aktet nënligjore dhe rregulloret kryesore në mënyrë që Gjykata e Lartë të jetë funksionale. Këto norma kanë të bëjnë me procedurën për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për përzgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë (kuota 4/5) dhe jogjyqtarë (kuota 1/5) të Gjykatës së Lartë. Autoritetet tregojnë se KLGJ-ja i ka paraqitur një listë me katër kandidatë jo gjyqtarë Presidentit të Republikës, i cili në muajin mars 2020 ka emëruar tre prej tyre. Kandidati i katërt pritet të emërohet në muajin shtator 2020. Vendimet e marra tashmë në dhomë këshillimi nga këta 3 gjyqtarë të sapoemëruar kanë rezultuar në ulje me rreth 700 çështje të numrit të përgjithshëm të çështjeve të prapambetura. Për sa i përket kuotës së kandidatëve gjyqtarë, kuadri i ri synon të sigurojë një proces objektiv dhe të paanshëm, bazuar në një procedurë transparente dhe konkurruese. Thirrjet për 11 vendet e lira janë mbyllur dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka filluar të vlerësojë aplikimet. Duke marrë parasysh procesin e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes, pritet që Gjykata e Lartë të bëhet plotësisht funksionale në vitin 2021.
31. Autoritetet raportojnë gjithashtu se është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi mes KLGJ-së dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID), që synon uljen e numrit të çështjeve të prapambetura: 12 punonjës po punojnë për inventarizimin në detaje të gati 35,000 çështjeve në pritje, të cilat do të përdoren për kategorizimin e çështjeve që do të trajtohen më pas nga këshilltarët ligjorë dhe gjyqtarët. Memorandumi i Mirëkuptimit parashikon gjithashtu modernizimin e proceseve të punës dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të Gjykatës për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e marrëdhënieve me publikun. Është hartuar një Udhërrëfyes për efikasitetin e Gjykatës së Lartë dhe uljen e numrit të çështjeve të prapambetura duke përfshirë promovimin e gjyqtarëve të kualifikuar dhe emërimin e më shumë këshilltarëve ligjorë.

32. Për sa i përket vlerësimit të gjyqtarëve, autoritetet shqiptare theksojnë tani se vlerësimi etik dhe profesional dhe rivlerësimi kalimtar (vetingu) janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe që të dy duhet të përdoren nga KLGJ për të përcaktuar statusin dhe karrierën e magjistratëve. Për sa i përket vlerësimit profesional të magjistratëve, neni 84 i ligjit nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve përcakton në mënyrë të hollësishme dhe proporcionale periudhat e vlerësimit për magjistratët sipas përvojës dhe pozicionit të tyre profesional: një herë në tre vjet gjatë 15 viteve të para të përvojës profesionale, dhe pastaj një herë në pesë vjet. Një kryetar gjykate vlerësohet të paktën një herë gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij/saj dhe të paktën gjashtë muaj para mbarimit të këtij mandati. KLGJ miratoi në 21 nëntor 2019 akte nënligjore plotësuese në lidhje me Skemën e re të Vlerësimit Gjyqësor, si dhe tabelat standarde me të dhënat e kërkuara statistikore për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve (19 Dhjetor 2019). Është përcaktuar një metodologji pikëzimi që synon përcaktimin e shkallëve të vlerësimit të gjyqtarëve dhe treguesit përkatës ligjorë në lidhje me cilësitë, kualifikimet, integritetin, aftësitë dhe efektivitetin e tyre, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjyqtarit. Janë përfunduar 250 vlerësime profesionale nga 466 gjithsej. Përsa i përket procesit kalimtar të rivlerësimit, Programi i Vlerësimit Gjyqësor Etik dhe Profesional i vitit 2020 parashikon rivlerësimin e 121 gjyqtarëve. Në total, në organet e pavarura të rivlerësimit kalimtar janë dërguar 216 relacione vlerësimi. Ndërkohë, është një total prej 389 gjyqtarësh që do t'i nënshtrohen procesit të ri-vlerësimit (25 kanë dhënë dorëheqjen), që do të thotë, sipas autoriteteve shqiptare, se procesi i rivlerësimit kalimtar po ecën mirë. Autoritetet shqiptare konsiderojnë që këto masa kontribuojnë për të mbushur hendekun kohor midis viteve të referencës dhe cikleve përkatëse të vlerësimit të gjyqtarëve. Ata pranojnë që vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe procesi i rivlerësimit janë dy procese të ndryshme. Megjithatë, ata theksojnë se të dy këto procese janë të ndërlidhura ngushtë për shkak të përbërësit të vlerësimit profesional i cili përdoret në të dy proceset ku KLGJ është autoriteti i vetëm përgjegjës që kryen vlerësimin.
33. Pjesa e parë e rekomandimit ishte konsideruar e zbatuar në mënyrë të kënaqshme në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë (Qershor 2018). Sidoqoftë, duke marrë parasysh kuadrin e rishikuar kushtetues dhe ligjor për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 25), GRECO vëren tani se pothuajse dy vjet më vonë, Gjykata e Lartë nuk është ende plotësisht funksionale. Në të vërtetë, janë emëruar vetëm një pjesë e kandidatëve jo gjyqtarë (1/5 e anëtarëve të Gjykatës së Lartë) dhe nuk është përfunduar procesi për zgjedhjen e pjesës së mbetur të 4/5 të gjyqtarëve sipas kuadrit të ri të vlerësimit dhe përzgjedhjes. Numri i çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë mbetet i lartë, megjithëse kohët e fundit janë bërë plane dhe janë marrë masa specifike për ta ulur atë. GRECO nxit autoritetet shqiptare të gjejnë zgjidhje të përshtatshme në mënyrë që Gjykata e Lartë të mund të funksionojë në përputhje me kuadrin ekzistues kushtetues dhe legjislativ. Është thelbësore që një Gjykatë e Lartë e depolitizuar dhe e pavarur të funksionojë plotësisht dhe me efikasitet sa më shpejt të jetë e mundur. Në situatën aktuale, GRECO nuk mund të mbajë përfundimin e tij të mëparshëm se pjesa e parë e këtij rekomandimi ishte zbatuar në mënyrë të kënaqshme. Prandaj, kjo pjesë e rekomandimit mbetet pjesërisht e zbatuar.
34. Përsa i përket pjesës së dytë të rekomandimit, GRECO vëren se reforma gjithpërfshirëse në drejtësi është ende në zbatim e sipër, përfshirë procesin në vijimësi të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve. Autoritetet shqiptare vlerësojnë se rezultatet e këtij procesi duhet të merren parasysh për përcaktimin e statusit individual dhe karrierës së gjyqtarëve, së bashku me vlerësimin profesional të tyre. Ky mund të jetë një proces mjaft i gjatë. Nga ana e tij GRECO konsideron se vlerësimi i aftësive profesionale dhe vlerësimi i integritetit duhet të jenë dy procese të ndara. GRECO është gjithashtu i vetëdijshëm se ritmi i procesit të ri-vlerësimit në zhvillim e sipër është shumë problematik për veprimtaritë e përditshme të gjykatave, pasi një

numër i konsiderueshëm gjyqtarësh kanë dështuar gjatë ri-vlerësimit dhe për këtë arsye nuk mund të punojnë më si gjyqtarë. Kështu, ndërsa pranojmë përpjekjet e bëra për të zgjidhur problematikën e çështjeve të prapambetura dhe të vlerësimeve që marrin kohë, nuk mund të nxjerrim përfundimin që aktualisht vlerësimet po kryhen në kohën e duhur, siç kërkohet nga rekomandimi. Prandaj, kjo pjesë e rekomandimit mbetet pjesërisht e zbatuar.

35. GRECO del në përfundimin që rekomandimi vi mbetet pjesërisht i zbatuar.

Rekomandimi vii.

36. *GRECO ka rekomanduar që i) "Komiteti i Etikës, Verifikimit të Mandateve dhe Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional" i Konferencës Kombëtare Gjyqësore të përmbushë mandatin e tij dhe të sigurojë në mënyrë proaktive zbatimin e rregullave të etikës; dhe që ii) gjyqtarëve t'u ofrohen udhëzime, këshillime dhe trajnim i detyrueshëm gjatë ushtrimit të detyrës lidhur me etikën, konfliktin e interesit dhe parandalimin e korrupsionit brenda radhëve të tyre.*
37. Kujtojmë që në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë, GRECO arriti në përfundimin se ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. Më saktësisht, GRECO vuri në dukje në mënyrë pozitive se reforma në drejtësi i kishte besuar KLGJ-së së sapo krijuar miratimin dhe monitorimin e standardeve etike gjyqësore dhe rregullave të sjelljes dhe se standarde të tilla ishin bërë aktuale në lidhje me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve për çrrënjosjen e korrupsionit nga gjyqësori. Sidoqoftë, ai theksoi se reforma në drejtësi mbetet për t'u zbatuar plotësisht dhe KLGJ-ja të bëhej funksionale. Pjesa e dytë e rekomandimit u konsiderua e zbatuar me krijimin, brenda KLGJ-së të një Këshilltari të Etikës për Gjyqësorin.
38. Autoritetet shqiptare përsërisin se reforma në drejtësi po zbatohet me shpejtësi në praktikë: KLGJ-ja është funksionale dhe ushtron *ndër të tjera* kompetencat e saj në lidhje me etikën gjyqësore dhe vlerësimin periodik të gjyqtarëve për kriteret profesionale dhe etike. KLGJ-ja ka ngritur katër komitete të përhershme, përfshirë Komitetin e Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili ka hartuar kriteret për vlerësimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Rregullorja është miratuar tashmë nga KLGJ-ja. Paralelisht, respektimi nga magistratët i rregullave etike i nënshtrohet procesit të ri-vlerësimit (shih Rekomandimin VI më lart). Administrata e KLGJ-së përfshin një Këshilltar për Etikën, të emëruar më datë 11 tetor 2019, përgjegjës për këshillimin e gjyqtarëve për çështje që lidhen me integritetin dhe etikën.
39. GRECO merr parasysh zhvillimet e reja që rezultojnë nga zbatimi i reformës në drejtësi, duke përfshirë funksionimin efektiv të KLGJ-së si organi kryesor përgjegjës për përparimin e standardeve etike në gjyqësor. Trajnimi gjatë ushtrimit të detyrës i magistratëve ishte përcaktuar tashmë në kohën e miratimit të Raportit të Përputhshmërisë dhe krijimi i një këshilltari për etikën në KLGJ, për këshillimin dhe vazhdimin e trajnimit, u pranua në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë
40. GRECO arrin në përfundimin që rekomandimi vii është trajtuar në mënyrë të kënaqshme.

Rekomandimi viii.

41. *GRECO ka rekomanduar se: i) me qëllimin për të garantuar mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve arbitrare në administrimin e drejtësisë, duhet të përcaktohet qartë shtrirja e të drejtës së Ministrisë së Drejtësisë për të shqyrtuar funksionimin e shërbimeve gjyqësore dhe administratën e gjykatave, sipas parashikimit të nenit 31 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë"; dhe se*

ii) kryetarëve të gjykatave përkatëse, duke përfshirë Kryetarin e Gjykatës së Lartë, duhet t'u jepet e drejta për të filluar procedime disiplinore ndaj gjyqtarëve.

42. Kujtojmë që në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë, GRECO arriti në përfundimin se ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. GRECO mirëpriti faktin që funksionimi i administratës gjyqësore ishte bërë kompetencë e KLGJ-së. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë në takimet e KLGJ-së por nuk ka të drejtë të votojë në lidhje me planifikimin strategjik dhe buxhetin e gjyqësorit. Ai gjithashtu mirëpriti krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përgjegjës për trajtimin e ankesave, hetimin e shkeljeve kryesisht dhe fillimin e procedurave disiplinore ndaj të gjithë gjyqtarëve, dhe konstatoi se Ministri i Drejtësisë mund t'i drejtohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëse ai ka informacion të besueshëm që një gjyqtar mund të jetë përgjegjës për shkelje. GRECO pranoi mënyrën e zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi. Sidoqoftë, thekson që posti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbetet për t'u plotësuar. GRECO vlerësoi pjesën e dytë të rekomandimit si të zbatuar, duke marrë parasysh që kryetarët e gjykatave kanë përgjegjësinë të sigurohen që në gjykatat e tyre respektohen standardet etike gjyqësore dhe ata mund të kërkojnë fillimin e procedurave në situata shkeljesh.
43. Autoritetet shqiptare shprehen tani që Kushtetuta e rishikuar përcakton kushtet dhe procedurat për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), si një organ i ri në sistemin e drejtësisë. Ai/ajo zgjidhet me një shumicë prej tre të pestat të të gjithë deputetëve të Kuvendit, për një mandat nëntë vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje, midis radhëve të juristëve të shquar me përvojë profesionale jo më pak se 15 vjet, me moral të lartë dhe integritet profesional. Kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur poste politike në administratën publike ose poste drejtuese në një parti politike në 10 vitet e fundit. ILD zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të zgjedhur dhe renditur në bazë meritash nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Nëse brenda 30 ditëve Kuvendi nuk arrin shumicën e kërkuar, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar. Këshilli (i përkohshëm) i Emërimeve në Drejtësi, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, ka rihapur thirrjen për aplikim për herë të dytë më datë 1 Mars 2019. Kanë aplikuar 13 kandidatë dhe një listë me 5 aplikantë është bërë publike në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi miratoi më datë 11 Mars 2019 një rregullore të hollësishme për përcaktimin e procedurave për verifikimin e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe ILD. Autoritetet shqiptare tregojnë se ILD u emërua më datë 20 Janar 2020.
44. GRECO përsërit se në vijim të reformave gjyqësore, funksionimi i administratës gjyqësore në një masë të madhe i është transferuar KLGJ-së. GRECO ka mirëpritur tashmë në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti përgjegjës për ankesat brenda Gjyqësorit. Këto masa synojnë mbrojtjen e gjyqësorit dhe gjyqtarëve nga ndërhyrjet arbitrare nga ekzekutivi, çka është dhe qëllimi i përgjithshëm i pjesës së parë të rekomandimit. GRECO ka konstatuar emërimin së fundmi të ILD dhe për këtë arsye konsideron se pjesa e parë e rekomandimit tani është e zbatuar. Pjesa e dytë ishte zbatuar sipas Raportit të Dytë të Përputhshmërisë.
45. GRECO del në përfundimin që rekomandimi viii është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Rekomandimi ix.

46. *GRECO rekomandoi përmirësimin e mëtejshëm të kriterëve për vlerësimin e cilësive etike të prokurorëve, duke garantuar në veçanti që kriteret të jenë objektive dhe transparente.*

47. Kujtojmë që në Raportin e Dytë të Përputhshmërisë, GRECO arriti në përfundimin se ky rekomandim ishte zbatuar pjesërisht. GRECO mirëpriti kuadrin ekzistues ligjor për vlerësimin e prokurorëve por konsideroi se ky kuadër nuk ishte ende funksional.
48. Autoritetet deklarojnë tani që Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) është krijuar dhe është funksional. Ai mbajti mbledhjen e tij themeluese më datë 19 dhjetor 2018 ku u zgjodhën edhe Kryetari dhe Zëvendëskryetari i tij. Më datë 26 shkurt 2019, Kuvendi miratoi një rritje të strukturës organizative të KLP në 65 punonjës, siç u kërkua nga KLP. Më datë 6 Mars 2019, KLP miratoi strukturën e saj organizative. KLP ka filluar të punojë konkretisht: ka miratuar disa rregullore mbi veprimtaritë e prokurorëve, organizimin e punës së tyre, menaxhimin e karrierës së tyre dhe stafin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar (SPAK). Ai ka punuar gjithashtu për trajnimin fillestar të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve të rinj, si dhe për procedurën për emërimin e Prokurorit të ri të Përgjithshëm. Ai ka komanduar gjithashtu përkohësisht 6 prokurorë për të mbështetur Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, i ngarkuar me përgatitjen e dosjeve të prokurorëve për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit.
49. GRECO risjell në vëmendje që standardet e etikës dhe sjelljes së prokurorëve janë përcaktuar në Ligjin Nr. 96/2016 për Statusin e Gjyqtarëve siç u konkludua në raportin e Dytë të Përputhshmërisë. Ai merr në konsideratë informacionin e dhënë së fundmi dhe mirëpret krijimin efektiv dhe funksionimin operacional të KLP. Ai thekson rolin e KLP-së në vlerësimin e cilësive etike të prokurorit, duke siguruar përkatësisht që kriteret janë objektive dhe transparente. Në këtë kontekst, ai gjithashtu mirëpret ngritjen konkrete të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale. GRECO i konsideron këto masa të mjaftueshme për të përmbushur rekomandimin aktual.
50. GRECO arrin në përfundimin që rekomandimi ix është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

III. PËRFUNDIME

51. **Duke marrë parasysh sa më sipër, GRECO arrin në përfundimin se Shqipëria ka zbatuar në mënyrë të kënaqshme ose ka trajtuar në mënyrë të kënaqshme nëntë nga dhjetë rekomandimet e përfshira në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Katërt.** Rekomandimi i mbetur është zbatuar pjesërisht.
52. Më konkretisht, rekomandimet i, ii, iii, iv, v, vii, viii, ix dhe x janë zbatuar në mënyrë të kënaqshme ose janë trajtuar në mënyrë të kënaqshme dhe rekomandimi vi mbetet i zbatuar pjesërisht.
53. Sa i përket *deputetëve*, një hap pozitiv përpara është miratimi i Kodit të Sjelljes në muajin prill 2018. Konfliktet e interesit duhet të deklarohen nga parlamentarët sapo ato lindin (ad hoc), ato regjistrohen, bëhen publike dhe monitorohen. Është përcaktuar edhe një procedurë për të siguruar që kontaktet me palët e treta gjatë procesit legjislativ të raportohen, regjistrohen dhe të bëhen publike. Janë miratuar gjithashtu Udhëzime për të plotësuar Kodin e Etikës dhe janë marrë masa të përshtatshme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe janë organizuar trajnime të deputetëve për këto rregulla, si dhe është ngritur një mekanizëm këshillimi, të cilit deputetët mund t'i drejtohen në situata dilemash etike. Janë krijuar dhe duket se po zbatohen procedura për të siguruar zbatimin e duhur të rregullave dhe sanksioneve përkatëse në rast shkeljesh. Periodiciteti i kontrolleve të deklaratave të pasurive të deputetëve është ulur dhe këto deklarata botohen në një faqe zyrtare në internet. Për më shumë, janë vendosur dhe zbatuar disa masa për të regjistruar dhe bërë

publike grupet e interesit dhe lobistët. GRECO inkurajon Parlamentin të vazhdojë përpjekjet e tij për reklamimin e masave të tilla.

54. Në lidhje me *gjqqtarët dhe prokurorët ("magjistratët")*, një reformë e gjerë e sistemit të drejtësisë është ende në vazhdim, dhe po kështu edhe procesi i ri-vlerësimit, me qëllimin për të luftuar korrupsionin në gjyqësor. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) janë funksionalë dhe trajtojnë organizimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe menaxhimin e karrierës së tyre, përfshirë vlerësimin e tyre profesional. Funksionimi i administratës gjyqësore nuk është më kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë, por i KLGJ-së. KLGJ-ja dhe KLP-ja janë përgjegjëse për përcaktimin e standardeve etike dhe monitorimin e tyre, çka është një zhvillim premtues. Politizimi i procesit të emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ka qenë i kufizuar, pasi kandidatët propozohen nga KLGJ-ja, e përbërë nga një shumicë gjyqtarësh të zgjedhur nga kolegët e tyre. Kuadri normativ në lidhje me përbërjen e Gjykatës së Lartë është hartuar në mënyrë të kënaqshme. Sidoqoftë, katër të pestat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nuk janë emëruar deri më tani, gjë që parandalon funksionimin efektiv të Gjykatës së Lartë dhe minon funksionimin e duhur të të gjithë sistemit gjyqësor. GRECO merr në konsideratë se procesi në vazhdim i rivlerësimit kalimtar të magjistratëve është i ndërlidhur me vlerësimin profesional të magjistratëve, i cili është një proces i gjatë. Sidoqoftë, ai konsideron se vlerësimi i aftësive profesionale dhe vlerësimi i integritetit duhet të jenë dy procese të ndara. Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti përgjegjës për trajtimin e ankesave dhe fillimin e procedimeve disiplinore ndaj të gjithë gjyqtarëve është një aspekt pozitiv i reformës në drejtësi në vazhdim. GRECO inkurajon autoritetet shqiptare për të siguruar përfundimin e shpejtë dhe zbatimin efektiv të procesit të reformës në drejtësi në mënyrë që të forcojnë në mënyrë efektive pavarësinë e gjyqësorit dhe luftën kundër korrupsionit brenda gjyqësorit.
55. Miratimi i këtij Raporti të Dytë të Përputhshmërisë përfundon procedurën e Raundit të Katërt të Përputhshmërisë në lidhje me Shqipërinë. Sidoqoftë, autoritetet e Shqipërisë mund të dëshirojnë të informojnë GRECO për zhvillimet e mëtejshme në lidhje me zbatimin e rekomandimit vi të mbetur dhe reformën e përgjithshme në sistemin e drejtësisë.
56. Së fundmi, GRECO fton autoritetet shqiptare që sa më shpejt të jetë e mundur, të autorizojnë publikimin e këtij raporti, përkthimin e tij në gjuhën kombëtare dhe bërjen publike të përkthimit.